



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOŠOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 180/22
Datë/Datum: 15.06.22
PRISHTINë

RAPORTI IEKSPERTIT SHQYRTUES

Emri dhe Mbiemri i eks. Shqyrtues dhe nënshkrimi Shqipe Hoti	Data e autorizimit të ekspertit 07.06.2022	Data e dorëzimit të raportit 15.06.2022	Nr. i lëndës: 180/2022
---	---	--	---------------------------

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 02.06.2022 “MEB L.L.C”- Prizren, ka parashtruar ankesë me nr: 180/2022, kundër njoftimit përmbi vendimin e autoriteti kontraktues të datës 17.05.2022 –Njoftim për dhënie të kontratës lidhur me të aktivitetin e prokurimit: “Sigurimi Fizik i Objekteve të MKK-së, me numër të prokurimit:211-22-2472-2-2-1/MK 211-22-003-221, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Ministria për Komunitetet dhe Kthim(në tekstin e më poshtëm MKK) .

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: shërbime, vlere e mesme.

Nëse është e përsëritur ankesa, të shënohet se lidhur me këtë lëndë është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP-së,

Ankesa është e përsëritur, fillimisht k a qenë ankesa me nr. te protokollit 128/2022, e cila ankesë ka qen kundër Njoftimit për anulim te aktiviteti te prokurimit.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

(Të përshkruhendispozitat e shkelura dhe vetëm pikat e ankesës).

1. **Shkeljet në Ligjin e Prokurimit publik;**
2. Neni 1. Qëllimi, Fushëveprimi, Përjashtimet, Përkufizimet
3. Neni 7. Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi dhe Transparenca
4. Neni 11. Informatat Sekrete Afariste
5. Neni 17. Llogaritja e Vlerës së Parashikuar të Kontratës për Shërbime
6. Neni 28. Specifikimet teknike
7. Neni 29. Variantet e Specifikimeve teknike
8. Neni 57. Sigurimi i tenderit
9. Neni 60. Kriteret për dhënien e kontratës
1. Neni 64. Dëshmitë e kërkesave

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Faktet dhe argumentet për shkeljet në procedurë:

Neni 1. Qëllimi, Fushëveprimi, Përfshirjet, Përkufizimet

1. Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla.

- **Pretendimi 1:** Autoriteti Kontraktues - MKK përmes njoftimeve mbi vendimin e AK të datës 17.05.2022 nuk e ka respektuar Nenin 1 të LPP, ku theksohet që do të sigurojë që në mënyrë efikase dhe transparente të shfrytëzojë fondet publike. Përmes këtij njoftimi dhe qasjen në dokumente zyrtare. **AK-MKK ka shkelur parimin e transparencës dhe efikasitetit duke mos ofruar asnjë dokument në lidhje me Grupin e Operatoreve Ekonomik përfitues.**

Neni 7. Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi dhe Transparenca

1. Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-di skriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.

- **Pretendimi 2;** Në pikën 1 të Nenit 7, theksohet fare qartë se AK do t'i trajtoje të gjithë operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo diskriminues dhe të veprojë në mënyrë transparente. Këtu si Operator Ekonomik pjesëmarrës në procedurë mendojmë se janë shkelur tri shtyllat kryesore të këtij neni nga ana e Autoritetit Kontraktues. Ku për tri here me radhë është shpallur fitues një Grup i Operatoreve Ekonomik ku ne si konkurrent të tregut me ta nuk kemi asnjë qasje në dokumentet e tyre.

Neni 11. Informatat Sekrete Afariste

1. Pa predikuar detyrimin për t'u siguruar palëve të interesuara dhe publikut qasje në shënimet e aktivitetëve të tij të prokurimit, autoriteti kontraktues duhet të respektojë dhe të mbajë si sekret informatat e klasifikuara si informata sekrete afariste në përputhshmëri me këtë nen.

- **Pretendimi 3:** Autoriteti Kontraktues shkele Nenin 11, duke e kombinuar me Nenin 68 dhe 69. Si operator Ekonomik theksojmë që nuk është respektuar Neni 11 për këto arsyeje. Në dosjen e tenderit, kërkohen këto dokumente:

1. Certifikata e regjistrimit të biznesit - **Dokument publik**
2. Certifikata e regjistrimit të TVSH-së - **Dokument publik**
3. Licenca për ushtrimin e veprimtarisë e lëshuar nga MPB — **Dokument publik**
4. Licenca e frekuencave për sistemin e radio komunikimit, lëshuar nga ARKEP - **Dokument publik.**

Si ka mundësi të klasifikohen këto 4 dokumente zyrtare të lëshuara nga Autoritetet Publike si dokumente sekrete. Qëllimi jonë kryesor si Operator të Interesuar është t'i analizojmë këto dokumente se a janë në përputhje me dëshmitë e kërkuara nga Autoriteti Kontraktues dhe dy licencat të analizohen për afatin e validitetit.

Neni 57. Sigurimi i tenderit

1. Gjatë një aktiviteti të prokurimit që shpie drejt dhënies së një kontrate me vlerë të mesme ose të madhe, autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga tenderuesit që të depozitojnë siguri (garantim) për tender. Siguria e tenderit që është depozituar nga tenderuesi do të konfiskohet.

- **Pretendimi 4.** Pse duhet të llogaritet dokument sekret, sigurimi i tenderit i përcaktuar në Dosjen e Tenderit, kur dihet që nëse ky kriter nuk është nën validitetin e kërkuar dhe mbulueshmerinë financiare të kërkuara shpallë në mënyrë automatike si Ofertë të Papërgjegjshme.

Neni 64. Dëshmitë e kërkesave

Një kandidat ose tenderues do të dëshmojë me certifikatë, vërtetim apo dëshmi të tjera të mjaftueshme të kërkuara në mënyrë të arsyeshme nga Autoriteti Kontraktues që: (i) arsyet për mos-kualifikim sipas nenit 65 të këtij ligji nuk zbatohen; (ii) të verifikojë përshtatshmërinë e tij profesionale, siç kërkohet nga Autoriteti Kontraktues sipas nenit 66 të këtij ligji; (iii) i plotësojnë kriteret e kërkuara nga Autoriteti Kontraktues sipas nenit 68-71 të këtij ligji.

- **Pretendimi 5.** Autoriteti Kontraktues shkel nenin 11 duke e kombinuar me Nenin 64, ku në kërkesën tonë për qasje në dokumente zyrtare nuk paraqiten dokumentet:

1. Një vërtetim i nënshkruar nga Administrata Tatimore e Kosovës e vendit tuaj të themelimit, se ju nuk jeni me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit përpara dorëzimit të tenderit. Duhet të dorëzohen vetëm nga tenderuesi fitues, para publikimit të dhënies së kontratës - **Dokument publik**
2. Vërtetimin nga Gjykata themelore - **Dokument publik**

Këto dy dokumente duhet të dërgohen për dy operatorët ekonomik të konzorciumit, asnjëri nuk na është

dorëzuar nga ana e AK-MKK.

Neni 17. Llogaritja e Vlerës së Parashikuar të Kontratës për Shërbime, Neni 28. Specifikimet teknike dhe Neni 29. Variantet e Specifikimeve teknike:

1. Vlera e parashikuar e kontratës së propozuar për shërbime është e barabartë me pagesën e përgjithshme dhe shumat e kompensoheshe që do të paguheshin nga autoriteti kontraktues sipas kontratës, përgjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës, duke pasur parasysh dispozitat e këtij neni. Gjatë përcaktimit të vlerës së parashikuar të një kontrate të propozuar për shërbime, autoriteti kontraktues do t'i përfshijë të gjitha elementet e çmimit përfundimtar që mund të parashikohen në mënyrë të arsyeshme, që do të paguhet nga autoriteti kontraktues për shërbimet dhe lëndët e tilla, duke përfshirë çfarëdo dhe të gjitha taksat, detyrimet dhe tarifatat e tjera.

• **Pretendimi 6.** Bazuar në specifikimet e detyrueshme teknike, Autoriteti Kontraktues Ministria për Kthim dhe Komunitete nuk ka respektuar piken 1 të nenit 17, duke mos i përfshirë të gjitha elementet që qojnë të çmimi përfundimtar. Përmes këtij pretendimi si Operator Ekonomik pjesëmarrës në Procedurë ndërlidhemi edhe Nenin 28 dhe 29 të LPP që kanë të bëjnë me specifikimet teknike dhe variantet e specifikimeve teknike dhe shkeljet bazike mbi Ligjin e Punës në Kosovë. Shembull detal:

Kërkohet që mbikëqyrja e objektit duhet të jete 24h pa ndërprerë, duhet të jenë të angazhuar 4 punëtorë, gjatë orarit të punës nga ora 8:00 deri 16:00 duhet të jene të angazhuar dy (2) punëtorë.

• 4 punëtor për 24h (ku dy prej tyre punojnë në ndërrimin e njëjta), këtu kemi të bëjmë me 8 orë pune në ditë dhe duke e ditur që kërkohet me sistemin 24/7 kemi të bëjmë me $8h \times 7 = 56$ orë pune në javë, kur dihet që me Ligjin e Punës mbulues mëria e punëve është 40 orë në javë me mundësi të punës shtesë jo me shumë se 40 orë tjera në muaj. Në këtë rast nëse analizojmë sistemin e orëve të punës $8 \times 30(31) = 240$ orë punë e në disa raste edhe 248 orë punë (këtu kjo llogaritje parashihet edhe me orët totale të përcaktuara 8929 ore pune totale /12 muaj / 3 punëtor është 248 orë pune në muaj) e cila shkel Ligjin e Punës (mermi informacionet konkrete).

LIGJI Nr. 03/L-212 I PUNËS:

Neni 20 Përcaktimi i orarit të punës 1. Orari i punës nënkupton periudhën kohore, gjatë së cilës i punësuar kryen punë ose shërbime në të mirë të punëdhënësit. 2. Orari i plotë i punës zgjat dyzet (40) orë në javë, nëse me këtë ligj nuk është përcaktuar ndryshe. 3. Orari i plotë i punës për të punësuarin, i cili është më i ri se tetëmbëdhjetë (18) vjeç, nuk mund të jetë më shumë se tridhjetë (30) orë në javë.

Neni 23. Puna më e gjatë se orari i plotë i punës 1. Në raste të jashtëzakonshme, me rritjen e vëllimit të punëve dhe në raste të tjera të domosdoshme, me kërkesën e punëdhënësit, punëtori duhet të punojë me gjatë se orari i punës (puna jashtë orarit), më së shumti deri në tetë (8) orë në javë. Pika 8 e nenit 23, theksohen edhe këto detaje: Inspektori i Punës ndalon punën jashtë orarit, nëse ajo ndikon dëmshëm në shëndetin dhe aftësinë

punuese të të punësuarit.

Si Operator Ekonomik pjesëmarrës theksojmë që këtu kemi të bëjmë me një pune shtese shume te ngarkuar andaj edhe nuk kemi mundësi te ngarkesës te cilat nuk respektohen me dispozitat ligjore ne Kosovë.

Neni 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës

1. Autoriteti kontraktues do të përcaktojë në dosjen e tenderit nëse kontrata publike do t'i jepet: 1.1. tenderuesit që ka dorëzuar tender të përgjegjshëm me çmimin më të ulët;

Pretendimi 7. Si Operator Ekonomik nuk kemi marrë asnjë dokument i cili na bind që Grupi i Operatoreve Ekonomik të përzgjedhur nga ana e juaj si Autoritet është i përgjithshëm dhe ka çmimin me të ulët, këtu shkelet edhe Neni 58, ku Autoriteti kontraktues nuk ka bashkangjitur asnjëherë Formularin e Procesverbalit të Hapjes dhe ne si Operator Ekonomike nuk kemi parë përshkrimin e çmimit nëse në të nuk ka intervenime, ka gabime aritmetikore ose të ngjashme.

Autoriteti Kontraktues - Ministria për Komunitete dhe Kthim ne trajtimin e vendimit 24.05.2022, nuk e trajton plotësisht kërkesën tonë për rishqyrtim, ku se bashku trajton pretendimin 1,2,3,4 dhe 5 trajton kërkesën në mënyrë të mangët dhe duke mos u mbështetur në asnjë Nen as të LPP as të RRUOPP. Analizoni sqarimet nga ana e AK- MKK-së:

Pretendimi 1. AK ju ka lejuar te keni qasje ne dokumentet zyrtare si dhe ju kemi ofruar dokumente me veti te cilat i keni kërkuar ju si OE.

Pretendimi 2,3,4,5,. Ju si OE keni kërkuar te keni qasje vetëm ne kontrata dhe referencat e OE dhe jo ne dokumente tjera te cilat I keni cekuar ne Pretendimet 2,3/4,5, ku ne ju keni treguar qe ato dokumente OE i rekomanduar për kontrate i ka cilësuar si sekrete afariste. Juve ju është dhënë kopje dokumenti ne te cilin OE i ka caktuar këto dokumente si sekret afarist.

Autoriteti Kontraktues - Ministria për Komunitete dhe Kthim nuk e trajton fare pretendimin tonë të 6, ku vetëm jep udhëzime se cilat kanë qenë hapat qe ne si OE është dashur t'i respektojmë.

- Autoriteti Kontraktues - Ministria për Komunitete dhe Kthim shkel ne mënyrë direktë Neni 17. Llogaritja e Vlerës së Parashikuar të Kontratës për Shërbime, Neni 28. Specifikimet teknike dhe Neni 29. Variantet e Specifikimeve teknike

Autoriteti Kontraktues - Ministria për Komunitete dhe Kthim nuk e trajton fare shkeljet e LIGJI Nr. 03/L-212 I PUNËS dhe Nenit 20, 23 dhe pika 23.8 e cila ndërlidhet me shkeljet e nenit 17, 28 dhe 29 të LPP-së.

Autoriteti Kontraktues - Ministria për Komunitete dhe Kthim në pretendimin 7. nuk jep asnjë detaj për procesverbalin e hapjes i cili as sot nuk është ne platformën elektronike (të bashkangjitur gjeni Screen se çfarë ne te vërtet shfaqet ne këtë procedure.

Pretendimet ankimore te parashtruara ne ankesën e deponuar në OSHP, janë/nuk janë te njëjta.

Përgjithësisht pretendimet janë të njëjta.

KRITERET PËR VLERËSIM

Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale

Profesionalna podobnost

- 1.Certifikata e regjistrimit të biznesit
- 2.Certifikata e regjistrimit të TVSH-së
- 3.Licenca për ushtrimin e veprimtarisë e lëshuar nga MPB
- 4.Licenca e frekuencave për sistemin e radio komunikimit, lëshuar nga ARKEP

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

- 1.Certifikata e regjistrimit të biznesit (Kopje)
- 2.Certifikata e regjistrimit të TVSH-së (Kopje)
- 3.Licenca për ushtrimin e veprimtarisë e lëshuar nga MPB - valide
- 4.Licenca e frekuencave për sistemin e radikomunikimit, lëshuar nga ARKEP - (kopje).

Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare	8.1 & 8.2	Ekonomski i finansijski kapacitet	<i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i>
	9.1 & 9.2	Tehničke i profesionalne mogućnosti 1.OE duhet të dëshmojë se ka përfunduar me sukses kontrate lidhur me shërbime të sigurimit apo të ngjashme realizuar në tri vitet e shkuara nga data e publikimit të këtij njoftimi. 2.Rojet e angazhuara duhet të jenë të licencuara me licence certifikate të vlefshme individuale të sigurimit themelor sipas nenit 14,20 dhe 27 të LSHPS 04 L-004.	<i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i> 1.Lista e kontratave të bashkangjitur me referenca. 2.Lista e punëtorëve të cilët do të angazhohen në këtë projekt, minimumi 4, bashkangjitur licencën certifikatën e sigurimit për secilin punëtor, kontratat e punës.
Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale			

RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim:

(Të përshkruhet vetëm vlerësimi i ofertës së OE ankues /ofertave, për të cilat OE ankues ka pretendime ankimore).

Komisioni ka vlerësuar se OE i rekomanduar për dhinë te kontratës i plotëson kërkesat e AK-se dhe rekomandon për nënshkrimet kontratës OE “JAGUAR SECURITY”SHPK- Prizren & SKYFTERAT LIVE SHPK me çmim prej 13,750.56€.

Ankesa është kundër Vendimit te AK-së Njoftim për dhënie te kontratës

INFORMACIONET SHITESË TË MARRA ME ANË TË SQARIMEVE TË KERKUARA NGA E EKSPERTËVE SHQYRTUES DHE / OSE TEKNIK

N/A

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP-së

(Të jepet një vlerësim se OE ankues është apo nuk është palë me interes sipas nenit 4.1.26).

N/A

VENDIMET E MËPARSHMETË PSH-së LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

(Të sqarohet nëse për rastin e njejtë është dhënë vlerësim tjetër).

N/A

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

(Të sqarohet për rastin se pse është devijuar nga praktika e mëparshme).

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES “MEB L.L.C”- Prizren

SQARIM :

Me datën 29.03.2022, për aktivitetin e prokurimit me titull “Sigurimi Fizik i Objekteve të MKK-së, me numër të prokurimit:2011-220-03-2-2-1, AK ka publikuar Njoftimin për kontratë, hapja e ofertave është bërë me datën:18.04.2022 ora 11:00h.

Me datën: 27.04.2022, AK ka publikuar Vendimin e tij - Njoftim për dhënie të kontratës ku i rekomanduar për dhënie të kontratës ka qenë OE “JAGUAR SECURITY”SHPK- Prizren & SKYFTERAT LIVE SHPK me çmim prej 13,750.56€.

Kundër vendimit të lartcekur operatorët ekonomik të pa kënaqur me këtë vendim të AK-së, brenda afatit ligjor kanë parashtruar kërkesën për rishqyrtim në AK.

Me datën: 04.05.2022, AK merr vendim me të cilin aktivitetin e prokurimit në fjalë e anulon me arsyetim se “Ministria për Komunitete dhe Kthim anulon aktivitetin e prokurimit për arsye se pas pranimit të kërkesës për rishqyrtim kemi vërejtur se specifikacioni nga njësia kërkues ko parapare katër(4) punëtorë, kurse në orët e llogaritura dhe sipas ligjit të punës për orët e punuara është konstatuara se këtë projekt duhet të jenë minimumi pesë (5) punëtorë”

Me datën 04.05.2022, OE ankues ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues kundër Njoftimit mbi vendimin e AK-së -Njoftim për anulimin e aktivitetit të prokurimit, kurse me datën 05.05.2022 OE ankues ka pranuar Vendimin e AK-së, për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim.

Kundër vendimit datës : 05.05.2022 për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, OE ankues me datën: 06.05.2022, parashtron ankesë në OSHP me numër të protokollit 128/2022.

Me datën 16.05.2022, AK pranon raportin e ekspertit shqyrtues lidhur me pretendimet e ankesës me numër 128/22 të datës 04.05.2022 –të parashtruar kundër Vendimit të Ak-së - Njoftim për anulim të aktiviteti të prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Sigurimi Fizik i Objekteve të MKK-së, me numër të prokurimit:2011-220-03-2-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Ministria për Komunitetet dhe Kthim.

AK dhe OE ankues brenda afatit ligjor kthej përgjigje në raportin e datës 16.05.2022 me nr. 128/22, ku të dyja palët pajtohen me raportin e ekspertit shqyrtues që aktiviteti i prokurimit në fjalë të kthehet në Rivlerësim.

Pas rivlerësimit të ofertave AK me datën 17.05.2022, bën publikimin e Vendimit të saj - Njoftim për dhënie të kontratës me të cilin Njoftim shpërblen me kontratë konsorciumin OE “JAGUAR SECURITY”SHPK- Prizren & SKYFTERAT LIVE SHPK me çmim prej 13,750.56€.

Kundër vendimit të datës 17.05.2022, OE “MEB L.L.C”- Prizren, parashtron kërkesë për rishqyrtim në AK. Autoriteti kontraktues me datën 24.05.2022, merr vendim për refuzim të kërkesës së OE ankues.

I pa kënaqur me vendimin e AK-së, të datës 24.05.2022, OE ankues “MEB L.L.C”- Prizren, me datën 02.06.2022, parashtron ankesë në OSHP, ankesë kjo e protokolluar me numër të protokollit 180/2022.

PRETENDIMI NR. 1. Lidhur me pretendimin e ankuesit, se Neni 1. Qëllimi, Fushëveprimi, Përfshirjet, Përkufizimet.

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “ MEB L.L.C”- Prizren, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Sigurimi Fizik i Objekteve të MKK-së, me numër të prokurimit:2011-220-03-2-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Ministria për Komunitetet dhe Kthim.

Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla.

Autoriteti Kontraktues - MKK përmes njoftimeve mbi vendimin e AK të datës 17.05.2022 nuk e ka respektuar Nenin 1 të LPP, ku theksohet që do të sigurojë që në mënyrë efikase dhe transparente të shfrytëzojë fondet publike. Përmes këtij njoftimi dhe qasjen në dokumente zyrtare. AK-MKK ka shkelur parimin e transparencës dhe efikasitetit duke mos ofruar asnjë dokument në lidhje me Grupin e operatoreve e ekonomik përfitues.

PËRGJIGJE NË PRETENDIMIN NR. 1.

Lidhur me pretendimin e lartcekur konsiderojmë se neni 11.3 i LPP-së specifikon: **Sekrete Afariste**

Autoriteti kontraktues mund t'i klasifikojë informatat e tjera si informatë sekrete afariste vetëm nëse informata përkatëse i përmbushë këto tri kritere:

- që atë ta ketë dërguar një operator ekonomik në përputhje me kërkesën e përcaktuar nga autoriteti i tillë kontraktues sipas nenit 68 ose 69 të këtij ligji; që operatori përkatës ekonomik t'i ketë dërguar autoritetit kontraktues kërkesën me shkrim duke shprehur dëshirën e tij që autoriteti kontraktues t'i mbajë artikujt e tillë si sekret; dhe
- kërkesa e tillë me shkrim të përmbajë një deklaratë me shkrim (i) në të cilën vërtetohet se një element i tillë nuk është pronë publike, dhe se të dhënat mbrohen nga operatori ekonomik nga zbulimi i qëllimshëm ose nga pakujdesia, dhe
- (ii) me të cilin parashtrohen arsyet, që bindshëm demonstrojnë, sipas gjykimit të arsyeshëm të autoritetit kontraktues, se qasja publike në elementin e tillë do të rezultonte në dëmtimin material të interesave legjitime komerciale të operatorit të tillë ekonomik. Autoriteti kontraktues që e ka klasifikuar një element të informatës si informatë sekrete afariste sipas paragrafit 3. të këtij neni, do të përgatit versionin e "pastruar" të çdo dokumenti, nëse elementi i tillë

gjendet në dokumentin në të cilin po ashtu gjendet informacioni që nuk konsiderohet të jetë sekret. Versioni i tillë i pastruar duhet të përfshihet në materialin në të cilin ka qasje publiku dhe palët e interesuara sipas nenit paragrafit 3. të nenit 10 të këtij ligji. Autoriteti kontraktues do të bashkëngjisë në ballinë të versionit të tillë të pastruar një njoftim që thotë se (i) autoriteti kontraktues i ka klasifikuar disa elemente të caktuara të informatës në dokumentin origjinal si informata sekrete afariste, me kërkesën e operatorit përkatës ekonomik, dhe (ii) versioni i pastruar i bashkangjitur është përgatitur nga autoriteti kontraktues dhe është një kopje e saktë e origjinalit pas heqjes ose fshirjes së informatave të tilla sekrete afariste.

Nëse dokumenti përmban vetëm informacione që autoriteti kontraktues i ka klasifikuar si informacione sekrete afariste sipas paragrafit 3. të këtij neni, dhe prandaj ky autoritet kontraktues vendos që këtë dokument ta largoj nga materiali në të cilin palët e interesuara dhe anëtarët e publikut kanë të drejt qasjeje sipas paragrafit 3. të nenit 10 të këtij ligji, autoriteti kontraktues duhet të përgatis dhe përfshijë në dokumentacionin në të cilin publiku ka qasje, një përmbledhje të përmbajtjes së përgjithshme të dokumentit sekret. Autoriteti kontraktues do të bashkëngjisë në ballinë të përmbledhjes së tillë një njoftim që thotë se (i) autoriteti kontraktues i ka klasifikuar të gjitha informacionet që gjendeshin në dokumentin origjinal si informata sekrete afariste, me kërkesë të operatorit përkatës ekonomik, dhe (ii) se dokumenti i bashkangjitur është përgatitur nga autoriteti kontraktues dhe se është një përmbledhje e përgjithshme jo-sekrete origjinalit. Nëse, në lidhje me ushtrimin e aktivitetit të prokurimit, autoriteti kontraktues kërkon nga një operator ekonomik që të dorëzojë informatat që mbulohen nga neni 68 dhe/ose 69 të këtij ligji, autoriteti i tillë kontraktues në dosjen e tenderit duhet të përfshijë një deklaratë duke i njoftuar operatorët ekonomik se, nëse ata dëshirojnë që informatat në fjalë të trajtohen si informata sekrete afariste, ata duhet të dorëzojnë një kërkesë me shkrim në përputhshmëri me paragrafin 3 të këtij neni.

Poshtu edhe opinionin e KRPP-së, jep sqarim se:

87. 25.11.2021 A mund të klasifikohen nga AK dokumentet e identifikuara nga OE në Sistemin Elektronik të Prokurimit Publik si "sekret afarist"?

Konform nenit 87, paragrafit 2, nën paragrafit 2.8 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr.05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, KRPP në përputhje me nenin 11 të këtij ligji, sqaron si në vijim:

Operatori Ekonomik, përveç se i identifikon ("markon") dokumentet si "sekret afarist" gjatë ngarkimit të tyre në Sistemin Elektronik të Prokurimit Publik, i njëjti **duhet** të plotësojë **Aneksin 3 të Dosjes së Tenderit "Kërkesa për sekret afarist"**.

Si rrjedhojë, nëse Operatori Ekonomik dëshiron që informatat e dorëzuara sipas nenit 68 dhe 69 të LPP-së të trajtohen nga Autoriteti Kontraktues si informata sekrete afariste në përputhje me nenin 11 të LPP-së, i njëjti duhet të shkarkojë nga sistemi **Aneksin 3 "Kërkesa për sekret afarist"**, të plotësojë, nënshkruaj dhe vulos, si dhe të ngarkojë në sistem së bashku me dokumentet tjera të tenderit të tij.

Duke pas parasysh faktin se operatori ekonomik i rekomanduar për dhënie të kontratës në pajtim me nenin 11 paragrafi 3 të LPP-së, ka plotësuar Aneksin 3 të Dosjes së Tenderit "Kërkesa për sekret afarist, ku ka kërkuar që dokumentet e tyre mbi kapacitetet teknike dhe profesionale të jen konfidenciale, dhe e njëjta kërkesë është aprovuar nga AK, konsiderojmë se mbi këtë bazë AK nuk mund ti lejoj qasje OE ankues në pjesën e dokumenteve të cilësuar si sekrete afariste të OE të rekomanduar për dhënie të kontratës, mirëpo AK duhet ta ketë parasysh faktin, se si sekrete afariste duhet cilësuar vetëm ato dokumente që janë kërkuar në pajtim me 68 dhe 69 të LPP-së, nga se neni 11 i LPP-së, sqaron se nëse dokumenti është cilësuar si dokument sekret afariste në pajtim me nenin 68 dhe 69 të LPP-së, AK nuk ka të drejt ti lejoj qasje asnjë OE të interesuar.

PRETENDIMI NR. 2. Lidhur me pretendimin ankuesit se Neni 7. Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi dhe Transparenca.

Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.

Në pikën 1 të Nenit 7, theksohet fare qartë se AK do t'i trajtoje të gjithë operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo diskriminues dhe të veprojë në mënyrë transparente. Këtu si Operator Ekonomik pjesëmarrës në procedurë mendojmë se janë shkelur tri shtyllat kryesore të këtij neni nga ana e Autoritetit Kontraktues. Ku për tri here me radhë është shpallur fitues një Grup i Operatoreve Ekonomik ku ne si konkurrent të tregut me ta nuk kemi asnjë qasje në dokumentet e tyre.

Neni 11. Informatat Sekrete Afariste

Pa predikuar detyrimin për t'u siguruar palëve të interesuara dhe publikut qasje në shënimet e aktiviteteve të tij të prokurimit, autoriteti kontraktues duhet të respektojë dhe të mbajë si sekret informatat e klasifikuara si informata sekrete afariste në përputhshmëri me këtë nen.

PËRGJIGJE NË PRETENDIMIN NR. 2.

Gjatë analizimit të aktivitetit të prokurimit dhe pas sqarimeve të marra nga AK kemi vërejtur se OE ankues ka parashtruar kërkesë me email për qasje në dokumente të OE të rekomanduar për dhënie të kontratës. Autoriteti kontraktues i është përgjigjur kërkesës së OE ankues, duke e njoftuar se për dokumente të cilat ky kërkon qasje, operatori ekonomik i rekomanduar për dhënie të kontratës ka plotësuar **Aneksin 3 të Dosjes së Tenderit “Kërkesa për sekret afarist”**. AK i ka fotokopjuar dëshminë OE ankues Deklaratën për konfidencialitet të OE të rekomanduar për dhënie të kontratës.

PRETENDIMI NR. 3. Lidhur me pretendimin e ankuesit se Neni 11. Informatat Sekrete Afariste Autoriteti Kontraktues shkele Nenin 11, duke e kombinuar me Nenin 68 dhe 69. Si operator Ekonomik theksojmë që nuk është respektuar Neni 11 për këto arsyeje. Në dosjen e tenderit, kërkohen këto dokumente:

1. Certifikata e regjistrimit të biznesit - Dokument publik
2. Certifikata e regjistrimit të TVSH-së - Dokument publik
3. Licenca për ushtrimin e veprimtarisë e lëshuar nga MPB — Dokument publik
4. Licenca e frekuencave për sistemin e radio komunikimit, lëshuar nga ARKEP - Dokument publik.

Si ka mundësi të klasifikohen këto 4 dokumente zyrtare të lëshuara nga Autoritetet Publike si dokumente sekrete. Qëllimi jonë kryesor si Operator të Interesuar është t'i analizojmë këto dokumente se a janë në përputhje me dëshmitë e kërkuara nga Autoriteti Kontraktues dhe dy licencat të analizohen për afatin e validitetit.

PËRGJIGJE NË PRETENDIMIN NR. 3:

Sqarojmë se, për pretendimin në fjale AK tek kresat edFDT-se ka kërkuar:

Profesionalna podobnost

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

1.Certifikata e regjistrimit të biznesit

1.Certifikata e regjistrimit të biznesit (Kopje)

2.Certifikata e regjistrimit të TVSH-së

2.Certifikata e regjistrimit të TVSH-së (Kopje)

Sqarojmë se OE ankues nuk ka ndonjë pretendim konkret për Certifikata e Regjistrimit të biznesit, e po ashtu edhe për Certifikatën e regjistrimit të TVSH-së —OE ankues nuk ka ngritur ndonjë pretendim se çka nuk përmbajnë këto dy dokumente . Sqarojmë se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës ka ofruar këto dy dëshmi.

Kurse sa i përket pretendimit të ankuesit për Licenca për ushtrimin e veprimtarisë e lëshuar nga MPB — Dokument publik; Licenca e frekuencave për sistemin e radio komunikimit, lëshuar nga ARKEP - Dokument publik, sqarojmë se AK për këtë pike ka kërkuar:

Sqarojmë se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës ka ofruar dy dëshmitë e lartcekura, ndërsa për licencat ka ofruar dëshmitë e lëshuara nga autoritetet kompetente, ku Licenca për ushtrimin e veprimtarisë e lëshuar nga MPB – valide, ka validitet 04.05.2024, ndërsa Licenca e frekuencave për sistemin e radio komunikimit, lëshuar nga ARKEP - (kopje), ka validitet deri me 20.09.2022. Nisur nga këto fakte konstatojmë se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës ka plotësuar kërkesën e AK-së, për dëshmitë ne fjalë sepse AK ka kërkuar:

3.Licenca për ushtrimin e veprimtarisë e lëshuar nga MPB

3.Licenca për ushtrimin e veprimtarisë
e lëshuar nga MPB - valide

4.Licenca e frekuencave për sistemin e radio komunikimit,
radiokomunikimit të lëshuar nga ARKEP

4.Licenca e frekuencave për sistemin e
lëshuar nga ARKEP - (kopje).

PRETENDIMI NR. Lidhur me pretendimin e ankuesit se Neni 57. Sigurimi i tenderit

Gjatë një aktiviteti të prokurimit që shpie drejt dhënies së një kontrate me vlerë të mesme ose të madhe, autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga tenderuesit që të depozitojnë siguri (garantim) për tender. Siguria e tenderit që është depozituar nga tenderuesi do të konfiskohet.

Pse duhet të llogaritet dokument sekret, sigurimi i tenderit i përcaktuar në Dosjen e Tenderit, kur dihet që nëse ky kriter nuk është nën validitetin e kërkuar dhe mbulueshmerin financiare të kërkuara shpallë në mënyrë automatike si Ofertë të Papërgjegjshme. **Neni 64. Dëshmitë e kërkesave**

Një kandidat ose tenderues do të dëshmojë me certifikatë, vërtetim apo dëshmi të tjera të mjaftueshme të kërkuara në mënyrë të arsyeshme nga Autoriteti Kontraktues që: (i) arsyet për mos-kualifikim sipas nenit 65 të këtij ligji nuk zbatohen; (ii) të verifikojë përshtatshmërinë e tij profesionale, siç kërkohet nga Autoriteti Kontraktues sipas nenit 66 të këtij ligji; (iii) i plotësojnë kriteret e kërkuara nga Autoriteti Kontraktues sipas nenit 68-71 të këtij ligji.

PËRGJIGJE NË PRETENDIMIN NR. 4.

Gjate analizimit të dëshmisë së kontestuar nga ankuesi (Sigurimi i tenderit) për OE të rekomanduar për dhënie të kontratës kemi hasur në dëshminë e sigurimit të tenderit të lëshuar nga një kompani e licencuar, ku në këtë dëshmi ndër tjera figuron emri dhe numri i aktiviteti të prokurimit në fjalë, tregohet se garancinë është në vlerë prej 1.000,00€, ky sigurim vlen për 90 ditë, dokumenti në fjalë është i nënshkruar dhe i vulosur dhe figuron të jetë i datës 18.04.2022. Andaj nisur nga këto fakte konsiderojmë se ky sigurim plotëson kërkesat e dosjes së tenderit sepse AK ka kërkuar : Shuma e Sigurimit të Tenderit duhet 1,000.00 Euro për periudhë valide prej 90 ditëve. **Sigurimi i tenderit duhet të ngarkohet së bashku me ofertën në sistemin e – prokurimit, dhe nëse jau kërkojmë të njëjtin duhet ta sjellin në zyrën e prokurimit**

PRETENDIMI NR.5. Lidhur me pretendimin e ankuesit se Autoriteti Kontraktues shkel nenin 11 duke e kombinuar me Nenin 64, ku në kërkesën tonë për qasje në dokumente zyrtare nuk paraqiten dokumentet:

Një vërtetim i nënshkruar nga Administrata Tatimore e Kosovës e vendit tuaj të themelimit, se ju nuk jeni *me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit përpara dorëzimit të tenderit.*

Duhet të dorëzohen vetëm nga tenderuesi fitues, para publikimit të dhënies së kontratës - Dokument publik Vërtetimin nga Gjykata themelore - Dokument publik Këto dy dokumente duhet të dërgohen për dy operatorët ekonomik të konzorciumit, asnjëri nuk na është dorëzuar nga ana e AK-MKK.

PËRGJIGJE NË PRETENDIMIN NR. 5.

Lidhur me këtë pretendim konsiderojmë se dokumentet e lartcekura janë dëshmi të cilat kërkohen që të ofrohen para nënshkrimit të kontratës nëse OE sipas LPP-se dhe RRUOPP nëse OE i rekomanduar për dhënie të kontratës dështon në sjelljen e këtyre dëshmimeve në kohen të cilën e kërkon AK tenderi i tyre duhet refuzohet dhe të vazhdohet me ofertën e radhës, andaj nisur nga ky fakt konsiderojmë se AK dëshmitë e lartcekura duhet ti kërkoj në pajtim me dispozitat e LPP-së dhe nëse OE në fjalë dështon në sjelljen e dëshmimeve sipas kërkesës se AK-së atëherë të vazhdohet me procedurave sipas LPP- së, dhe RRUOPP.

PRETENDIMI NR. 6. Lidhur me pretendimin e ankuesit se **Neni 17. Llogaritja e Vlerës së Parashikuar të Kontratës për Shërbime, Neni 28. Specifikimet teknike dhe Neni 29. Variantet e Specifikimeve teknike:**

1. Vlera e parashikuar e kontratës së propozuar për shërbime është e barabartë me pagesën e përgjithshme dhe shumat e kompensoheshe që do të paguhen nga autoriteti kontraktues sipas kontratës, përgjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës, duke pasur parasysh dispozitat e këtij neni. Gjatë përcaktimit të vlerës së parashikuar të një kontrate të propozuar për shërbime, autoriteti kontraktues do t'i përfshijë të gjitha elementet e çmimit përfundimtar që mund të parashikohen në mënyrë të arsyeshme, që do të paguhet nga autoriteti kontraktues për shërbimet dhe lëndët e tilla, duke përfshirë çfarëdo dhe të gjitha taksat, detyrimet dhe tarifat e tjera.

- Bazuar në specifikimet e detyrueshme teknike, Autoriteti Kontraktues Ministria për Kthim dhe Komunitete nuk ka respektuar piken 1 të nenit 17, duke mos i përfshirë të gjitha elementet që qojnë të çmimi përfundimtar. Përmes këtij pretendimi si Operator Ekonomik pjesëmarrës në Procedurë ndërlidhemi edhe Nenin 28 dhe 29 të LPP që kanë të bëjnë me specifikimet teknike dhe variantet e specifikimeve teknike dhe shkeljet bazike mbi Ligjin e Punës në Kosovë. Shembull detal:

Kërkohet që mbikëqyrja e objektit duhet të jete 24h pa ndërprerë, duhet të jenë të angazhuar 4 punëtorë, gjatë orarit të punës nga ora 8:00 deri 16:00 duhet të jene të angazhuar dy (2) punëtorë.

- 4 punëtor për 24h (ku dy prej tyre punojnë në ndërrimin e njëjta), këtu kemi të bëjmë me 8 orë pune në ditë dhe duke e ditur që kërkohet me sistemin 24/7 kemi të bëjmë me $8h \times 7 = 56$ orë pune në javë, kur dihet që me Ligjin e Punës mbulues mëria e punëve është 40 orë në javë me mundësi të punës shtesë jo me shumë se 40 orë tjera në muaj. Në këtë rast nëse analizojmë sistemin e orëve të punës $8 \times 30(31) = 240$ orë punë e në disa raste edhe 248 orë punë (këtu kjo llogaritje parashihet edhe me orët totale të përcaktuara 8929 ore pune totale /12 muaj / 3 punëtor është 248 orë pune në muaj) e cila shkel Ligjin e Punës (mermi informacionet konkrete).

LIGJI Nr. 03/L-212 I PUNËS:

Neni 20 Përcaktimi i orarit të punës 1. Orari i punës nënkupton periudhën kohore, gjatë së cilës i punësuar kryen punë ose shërbime në të mirë të punëdhënësit. 2. Orari i plotë i punës zgjat dyzet (40) orë në javë, nëse me këtë ligj nuk është përcaktuar ndryshe. 3. Orari i plotë i punës për të punësuarin, i cili është më i ri se tetëmbëdhjetë (18) vjeç, nuk mund të jetë më shumë se tridhjetë (30) orë në javë.

Neni 23. Puna më e gjatë se orari i plotë i punës 1. Në raste të jashtëzakonshme, me rritjen e vëllimit të punëve dhe në raste të tjera të domosdoshme, me kërkesën e punëdhënësit, punëtori duhet të punojë me gjatë se orari i punës (puna jashtë orarit), më së shumti deri në tetë (8) orë në javë. Pika 8 e nenit 23, theksohen edhe këto detaje: Inspektori i Punës ndalon punën jashtë orarit, nëse ajo ndikon dëmshëm në shëndetin dhe aftësinë punuese të të punësuarit.

Si Operator Ekonomik pjesëmarrës theksojmë që këtu kemi të bëjmë me një pune shtese shume te ngarkuar andaj edhe nuk kemi mundësi te ngarkesës te cilat nuk respektohen me dispozitat ligjore ne Kosovë.

Neni 60 Kriteret për Dhënie të Kontratës

- I. Autoriteti kontraktues do të përcaktojë në dosjen e tenderit nëse kontrata publike do t'i jepet: 1.1. tenderuesit që ka dorëzuar tender të përgjegjshëm me çmimin më të ulët;

PËRGJIGJE NË PRETENDIMIN NR. 6.

Konsiderojmë se kjo nuk është faza kur operatorët ekonomik kanë mundësi të ndryshojnë kërkesat e dosjes së tenderit sepse për kërkesat e dosjes së tenderit të cilat operatorët e ekonomik të interesuar konsiderojnë se janë të vendosura në kundërshtim me LPP-në, është afati kohor për sqarime të dosjes si dhe afati kohor për ankese-kërkesë në AK, ku sipas LPP-së, për këtë pikë OE të interesuar mund të parashtrojnë kërkesë për rishqyrtim në AK pesë (5) ditë para afatit të fundit për dorëzim të ofertave ashtu siç specifikohet me nenin 108/A të LPPP-së.

Me vet faktin se OE ankues nuk ka parashtuar ankese-kërkesë në fazën e njoftimit për kontratë për kritere - kërkesa të dosjes së tenderit, len të kuptoj se ofertuesi është pajtuar me të gjitha kriteret dhe kërkesat e dosjes së tenderit.

PRETENDIMI NR.7. Lidhur me pretendimin e ankuesit se, si Operator Ekonomik nuk kemi marrë asnjë dokument i cili na bind që Grupi i Operatoreve Ekonomik të përzgjedhur nga ana e juaj si Autoritet është i përgjithshëm dhe ka çmimin më të ulët, këtu shkelet edhe Neni 58, ku Autoriteti kontraktues nuk ka bashkangjitur asnjëherë Formularin e Procesverbalit të Hapjes dhe ne si Operator Ekonomike nuk kemi parë përshkrimin e çmimit nëse në të nuk ka intervenime, ka gabime aritmetikore ose të ngjashme.

PËRGJIGJE NË PRETENDIMIN NR. 7.

Edhe përkundër faktit që OE ankues nuk kishte cekur fare në kërkesën e tij për qasje, se në cilat dokumente të OE të rekomanduar për dhënie të kontratës kërkon qasje, AK është dashtë që ti lejoj qasje në ato dokumente që nuk janë klasifikuar si sekrete afariste. Për mosdije të autoriteti kontraktues që të klasifikoj dokumentet e operatoreve ekonomik pjesëmarrës si sekrete afariste ashtu siç specifikohet në nenin 11 paragrafi 3 të LPP-së nuk duhet ti bart pasojat asnjërin nga operatorët ekonomik pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit, sepse OE i rekomanduar për dhënie të kontratës tek deklarata për konfidencialitet si dokumente konfidenciale ka kërkuar që të jenë dokumentet e kërkuara në bazë të kërkesave mbi mundësitë teknike dhe profesionale dhe kërkesën e tij për konfidencialitet e ka plotësuar konform nenit 11 të LPP-së. AK është dashur të dije se cila dokumente klasifikohen si dokumente sekrete afariste dhe vetëm pas klasifikimit të këtyre dokumenteve të

aprovoj kërkesën e OE të rekomanduar për dhënie të kontratës për konfidencialitet të dokumenteve. Duke pas parasysh faktin se eksperti shqyrtues është i obliguar që ta bej ekzaminimin , vlerësimin dhe krahasimin e ofertave në rastin konkret janë analizuar të gjitha pretendimet e ankuesit tek ato dokumente që ankuesit nuk ju është lejuar qasja dhe i është dhënë përgjigje për secilin dokument.

PRETENDIMI NR .8. Lidhur me pretendimin ankuesit se Autoriteti Kontraktues - Ministria për Komunitete dhe Kthim ne trajtimin e vendimit 24.05.2022, nuk e trajton plotësisht kërkesën tonë për rishqyrtim, ku se bashku trajton pretendimin 1,2,3,4 dhe 5 trajton kërkesën në mënyrë të mangët dhe duke mos u mbështetur në asnjë Nen as të LPP as të RRUOPP. Analizoni sqarimet nga ana e AK- MKK-së:

Pretendimi 1. AK ju ka lejuar të keni qasje në dokumentet zyrtare si dhe ju kemi ofruar dokumente me veti të cilat i keni kërkuar ju si OE.

Pretendimi 2,3,4,5,. Ju si OE keni kërkuar të keni qasje vetëm në kontrata dhe referencat e OE dhe jo në dokumente tjera të cilat I keni cekuar në Pretendimet 2,3/4,5, ku ne ju keni treguar që ato dokumente OE i rekomanduar për kontratë i ka cilësuar si sekrete afariste. Juve ju është dhënë kopje dokumenti në të cilin OE i ka caktuar këto dokumente si sekret afarist.

Autoriteti Kontraktues - Ministria për Komunitete dhe Kthim nuk e trajton fare pretendimin tonë të 6, ku vetëm jep udhëzime se cilat kanë qenë hapat që ne si OE është dashur t'i respektojmë.

- Autoriteti Kontraktues - Ministria për Komunitete dhe Kthim shkel në mënyrë direktë Nenit 17. Llogaritja e Vlerës së Parashikuar të Kontratës për Shërbime, Nenit 28. Specifikimet teknike dhe Nenit 29. Variantet e Specifikimeve teknike

Autoriteti Kontraktues - Ministria për Komunitete dhe Kthim nuk e trajton fare shkeljet e LIGJI Nr. 03/L-212 I PUNËS dhe Nenit 20, 23 dhe pika 23.8 e cila ndërlidhet me shkeljet e nenit 17, 28 dhe 29 të LPP-së.

Autoriteti Kontraktues - Ministria për Komunitete dhe Kthim në pretendimin 7. nuk jep asnjë detaj për procesverbalin e hapjes i cili as sot nuk është në platformën elektronike (të bashkangjitur gjeni Screen se çfarë ne te vërtet shfaqet në këtë procedure.

PËRGJIGJE NË PRETENDIMIN NR. 8.

Sqarojmë se Autoritet kontraktues me datën 24.05.2022, merr vendim me të cilin e refuzon kërkesën e OE ankues të datës 22.05.2022, vendimi është marr brenda afatit ligjor ku në këtë vendim AK jep një arsyetim

rreth ankesës në fjale. Neni 108/A i LPP- së specifikon që AK është i obliguar që të arsyetoj refuzimin e një kërkesë për rishqyrtim, në rastin konkret nuk mund të themi se mungon arsyetimi.

Lidhur me pretendimin e ankuesit se mungon procesverbali i hapjes, Eksperti sqaron se nëse i qasemi sistemit të e-prokurimit dhe klikojmë tek **rubrika Dokumentet tjera** i pari dokument që na del në faqe është procesverbali i hapjes, ky procesverbal hapet dhe figuron emrat e Operatoreve ekonomik pjesëmarrës, çmimi i tyre etj ...

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të refuzohet si e pa bazuar, vërtetohet vendimi i AK-së-Njoftimi për dhënie të kontratës i datës 17.05.2022.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- | | |
|---------------------------|---------------------------------------|
| - Autoritetit Kontraktues | - Ministria për Komunitetet dhe Kthim |
| - Panelit Shqyrtues | - OSHP. |
| - OE ankues | - "MEB L.L.C"- Prizren |